



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izbornni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.161/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se posterit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 04.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** e bazuar ankesa Anr.161/2019 e datës 01.10.2019 e paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike – vendosjes së posterit mbi rrugë publike, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 5,100,00 euro (pesëmijë e njëqind), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. Urdhërohet** subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që brenda afatit prej 24 orëve, nga pranimi i këtij vendimi, ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

## A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 30.09.2019, në rrugën për në fshatin Has të Komunës së Prizrenit, monitoruesi ynë ka hasur në poster të kandidatit për deputet nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i vendosur në hapësira publike përkatësisht mbi rrugë. Paraqitësi i ankesës më tutje thekson se subjekti politik PDK, ka vepruar në kundërshtim nën 33 par. 1 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës. Si provë për pretendimet e tyre paraqitësi ka bashkangjitur një (1) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të datës 02.10.2019, ka theksuar se vendosja është bërë nga simpatizantët e pa informuar për Rregullat Zgjedhore. Më tutje subjekti politik (PDK), deklaroi se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është ngjitur mbi rrugë publike për në fshatin Has-Komuna e Prizrenit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b), të LZP-së, e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur neni 33 pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik (PDK), është vendosur mbi rrugë publike.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje si dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me rregullat zgjedhore dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit për deputet të këtij subjekti politik është vendosur mbi rrugë publike.

Si rrethanë Paneli, morri edhe faktin që subjekti politik PDK në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje, mirëpo fotografia nuk ju ka bashkangjitur përgjigjes në ankesë. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 161/2019 më datën 02.10.2019.

**Kryesuesi i Panelit**  
Krustem Thaqi



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.